




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. N. fol	01-447/14
Dep. 2-D/DPK	
Nr. i faq	04-02-2014
Broj stranica	
Nr. pages	02



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	04.02.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Selami BERISHA Drejtor i Zyrës së Prokurimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik
CC:	z. Nazmi ZENELAJ Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin "Shërbimet këshillëdhënëse për Njësinë e Implementimit të Projektit (NJIP) TC Kosova e Re" Re



I nderuari z. Berisha,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Shërbimet këshillëdhënëse për Njësinë e Implementimit të Projektit (NJIP) TC Kosova e Re", me nr. të prokurimit: 1131311043221 Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohej nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Shërbimet këshillëdhënëse për Njësinë e Implementimit të Projektit (NJIP) TC Kosova e Re" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik ka përgatitë “Njoftimin për Kontratë” me titull “Shërbimet këshillëdhënëse për Njësinë e Implementimit të Projektit (NJIP) TC Kosova e Re” me nr. prokurimi: 1131311043221, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 19.12.2013, në Procedurë të Hapur. Agjencia Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim. Gjatë ekzaminimit të kësaj procedure të prokurimit në “Njoftimin për Kontratë”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me Procedurat e Prokurimit të cilat rregullohen me ligjin e Prokurimit Publik i cili është i zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Në “Njoftimin për Kontratë” të publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, më datë 19.12.2013, tek pika III.2 e rubrikës “Kushtet për pjesëmarrje”, Rubrika III.2.1 “Kërkesat e përshtatshmërisë” është kërkuar **Këshilltar për Çështje të Energjisë, Këshilltar Financiar dhe Ekonomik, Këshilltar Ligjor dhe Këshilltar për Marrëdhënie me Publikun.**

Autoriteti Kontraktues Ministria e Zhvillimit Ekonomik në “Njoftimin për Kontratë” dhe “Dosjen e Tenderit” ka paraqitur kritere të njëjta si tek “ Kërkesat e Përshtatshmërisë “ ashtu edhe tek “ Kriteret për dhënie të Kontratës “. A.K duhet të sigurojë që në “Njoftimin për Kontratë” dhe “Dosjen e Tenderit” të bëjë një dallim të qartë në mes kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve për dhënie të kontratës, sipas ligjeve në fuqi kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdorën në asnjë mënyrë si kritere për dhënien e Kontratës. Autoriteti Kontraktues në “Njoftimin për Kontratë” dhe “Dosjen e Tenderit” i ka përcaktuar si kritere të matjes me peshë të caktuar këto kërkesa si në vijim: pika 1. Kualifikimi minimal së paku Diploma e kërkuar Universitare), pika 2. Përvojë pune profesionale Së paku 5 vite përvojë pune në fushën e caktuar, pika 3. Aftësitë dhe njohuritë profesionale aftësitë dhe njohuritë profesionale lidhur me çështjet ligjore, financiare, teknike-energjetike, apo të marrëdhënieve me publikun, të specifikuara për çdo këshilltar, që janë kritike për arritjen e detyrave komplekse për përmbylljen e projekti, pika 4. Zotësi në programet kompjuterike dhe pika 5. Njohuri e gjuhës angleze në nivelin e lartë që mundëson kryerjen shërbimeve profesionale. Sipas Ligjeve në fuqi këto kritere do duhej të ishin të përcaktuara si kritere minimale për kualifikim.

Agjencia Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Zhvillimit Ekonomik që të jetë pjesë e monitorimit për tenderin me titull “Shërbimet këshillëdhënëse për Njësinë e Implementimit të Projektit (NJIP) “ TC Kosova e Re “ me nr. të prokurimit:1131311043221. Gjatë monitorimit të këtij aktiviteti të prokurimit është vërejtur se Autoriteti Kontraktues Ministria e Zhvillimit Ekonomik i ka përdorur kriteret e përzgjedhjes si kritere për dhënie të kontratës.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, me nenin 23 dhe nenin 25 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !